



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



I	Data	12.07.2022	Vendi	KAÇANIK
	Org.		Numri	Shtojcë
		01-060/04-19353		7.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Procesverbal nga Konsultimi Publik me temë : Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025

Koha:17.06.2022

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Ora:11:00

Duke u bazuar në ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, dhe nenin 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Komuna e Kaçanikut ka organizuar Debat Publik me temë: Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025.

Në takim prezantoi Kryetari Besim Ilazi dhe nënkryetari Sabedin Vishi. Kryetari Ilazi fillimisht inkurajoi qytetarët që të jenë pjesë e diskutimeve publike, në mënyrë që secili nga ta të ketë mundësinë e drejtpërdrejtë që të paraqes kërkesat e tyre, ndërsa tha se për vitin e ardhshëm janë afër 3 milion euro të parapara për investime komunale, andaj sygjeroi të pranishmit në debat që të orientojnë shpërndarjen sa më të drejtë dhe korrekte të këtyre mjeteve në projekte të ndryshme, që për qëllim kryesor kanë mirëqenien qytetare. Takimin e përshëndeti edhe kryesuesi i Kuvendit Komunal Kemajl Murseli, i cili shprehu rëndësinë e madhe të pjesëmarrjes së qytetarëve në debate publike, ngase sipas tij pjesëmarrja sa më e madhe e qytetarëve në këto takime publike ngrit edhe performancën komunale, ndërsa kërkoi që debati të orientohej që nga të hyrat buxhetore komunale e deri tek destinimi i tyre. Ndërkohë, Drejtori për Buxhet dhe Financa Bahri Selimi shpalosi disa detaje nga Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025. Drejtori Selimi tha se buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2023 do të tejkalon masën monetare prej 10 milion euro. Ai më tutje tha se përmes KABK është shpalosur vizioni afatmesëm komunal ku edhe realizimi i objektivave është paraparë të arrihen përmes hapave konkret dhe atë përmes caktimit të shumave buxhetore për secilin projekt dhe aktivitet.

Komentet:

Fadil Vishi- Dubravë:

Vazhdimi i trotuarit si dhe ndriçimi tek Ura e Lepencit, Rregullimi i Shtratit të përroskës deri tek Zharkt, rregullimi i rrugës Bob- Doganaj, zgjerimi dhe rregullimi i rrugës prej varrezave të Vishajve që lidhet me Topall. vendosja e disa kabinave për udhëtarë që presin autobusë, hapja dhe funksionalizimi i ambulantës në Dubravë

Hasip Salihu- Bajnicë:

Problemët ende vazhdojnë më ujin e pijes, kanalizimi I fshatit Semajë një pjesë e pa përfunduar, dëmtimi I asfaltit Bajnicë- Gabrricë.

Fatmir Bunjaku – Biqec

Rregullimi I ujërave atmosferike , zgjerimi I rrugës prej gjamisë për të përfshirë pastaj lagjet Gavaz, Shorr etj, si dhe në të njejtën kohë rregullimi I trotuarit, me u rregullu rruga alternative Biqec- Kacanik, rehabilitimi I përrockave, rregullimi I disa rrugicave të vogla, dhe si fshat na nevojiten disa gypa të ujësjetës

Afrim Fuga- Kacanik lagja “ Avdurrahim Shehu”

Në këtë lagje ende kemi problem me ujin e pijës si dhe ndotja e puseve.

Besnik dema Bob: Asfaltimi I rrugës deri tek varrezat e fshatit, Ambulanca të mbyllet si dhe të ndërrohet destinimi i objektit në fjalë, në një pjesë të lagjes Kukaj ka depërtuar kanalizimi në rrugë.

Ardiana Tusha: KVRL

Ka mungesë të mbikëqyrjes së inventarit tek Salla e Leximit, ku si KVRL kemi fituar një donacion dhe ai inventar tashmë nuk gjendet në sallën e leximit, kërkojmë përgjegjësi në lidhje me këtë, si dhe ju informoj se si KVRL tashmë kemi fituar një projekt më të madh që ka të bëjë me pajisjen e sallës së leximit me tërë inventarin e nevojshëm dhe shpresojmë që ky inventarë të ruhet. Takim I Kryetarit, kryesuesit dhe stafit ekzekutiv me nxënës të paktën 1 herë në 6 muaj.

Rakip Vishi- kodet buxhetore në vlerë 5 mijë euro të vogla për investime të mëdha sic janë paraqitur në tabela, psh pika 9 e shumë të tjera.

Muzafer Gashi- Begracë

A është planifikuar që nxehjet qendrore me dru, të investohet dhe të njejtat të kthehen me rrymë, për arsye të shtrenjtimit të drunjëve si dhe mbrojtjes së ambientit?

Lumbardh Malsiu: fshati Rekë

Rregullimi i rrugës Bob Doganaj, rregullimi i rrugës “ Fetije Qorri” që lidh fshatrat Rekë, Dubravë dhe Nikaj, rregullimi I përroskës në fshatin Rekë, si dhe ndërtimi i një kopshti për fëmijë në vendin e quajtur “ Kamenicë”.

Elmihane Krasniqi Organizata Handikos

Është për tu përshëndetur që është paraparë rregullimi i ashensorit në Gjimnazin “ Skendërbeu” sepse shumë nxënësve me nevoja të veçanta tashmë do tu mundësohet qasja, kërkojmë rritje të buxhetit për shërbimet shëndetësore për këtë kategori.

Të pranishmit në debat morën përgjigje dhe bashkëbiseduan me ekzekutivin komunal, ndërsa përgjigjet zyrtare janë të paraqitura edhe në raportin e konsultimit publik me po të njetën temë.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi

